



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Nr. 29 Prot.

Tiranë, më 30/06/2020

VENDIM

Nr. 14 datë 30.06.2020

PËR

**RIFILLIMIN E PROCESIT ZGJEDHOR PËR AUTORITETET DHE ORGANET
DREJTUESE NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË**

Në bazë të Urdhrit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 175, datë 30.06.2020 “Për zhvillimin e procesit zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë”, Rregullores së Zgjedhjeve miratuar nga Senati Akademik i UMT-së me Vendimin nr. 13, datë 12.02.2020 “Për miratimin e Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese dhe komisionet e përhershme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, si dhe Urdhrit të Rektorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë nr. 60, datë 30.06.2020 “Për shpalljen e zhvillimit të procesit zgjedhor ...”, Komisioni Institucional Zgjedhor në mbledhjen e datës 30.6.2020,

VENDOSI:

1. Rifillimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet e autoriteteve dhe organeve drejtuese në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, me datë 30 qershor 2020.
2. Data e zhvillimit të zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe organet drejtuese në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, është data 30 korrik 2020.
3. Fushata zgjedhore fillon me datë 30 qershor 2020 dhe përfundon 24 orë para ditës së zgjedhjeve.
4. Vendimi nr. 4, datë 13.5.2020 i KIZ “Për llogaritjen e afateve procedurale nga Komisioni Institucional Zgjedhor i UMT...”, shfuqizohet.
5. Vendimi nr. 13, datë 19.5.2020 i KIZ “Për pezullimin e procesit të aplikimeve për...”, shfuqizohet.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, afishohet në ambientet e UMT-së dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të UMT-së.

KRYETAR
SILVANA BALA

